



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

COVID-19 DHE SITUATA E RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE TË BURGOSURVE

BULETIN INFORMATIV

MAJ-SHTATOR 2020 | NR. 1

ÇËSHTJE NË VIJIM:

Ankesa - fq.1

Edicioni Special: Situata në burgje
gjatë COVID-19 - fq.2

Raste suksesi të asistuar ligjërisht
nga KSHH - fq.3

Roli advokues i KSHH në adresimin
e rekomandimeve- fq.4

Përfaqësim ligjor falas i shtetasve -
fq.5



Ankesat dhe veprimtaria e Klinikës së Ligjit pranë Komitetit Shqiptar të Helsinkit

Gjatë periudhës Maj-Shtator 2020, KSHH ka ofruar asistencë juridike ndaj publikut, duke mos u kufizuar vetëm tek të dënuarit. 115 qytetarë janë asistuar nëpërmjet këshillimeve ligjore dhe asistencës për plotësimin e dokumentacionit.

97 shtetas (rreth 84%) të ndodhur në kushtet e privimit të lirisë dhe/ose familjarët e tyre kanë adresuar ankesa ndaj shërbimit mjekësor (mungesë ilaçesh, mungesë vizitash tek mjeku specialist etj.); asistencë ligjore për të ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimeve të refuzimit për qëndrimin e përkohshëm në shtëpi të të dënuarve; marrje informacioni nga ana e stafeve institucionale etj.





KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Beteja ligjore e Komitetit Shqiptar të Helsinkit për të informuar publikun për përhapjen e Covid-19 në burgje

Të dhënat e siguruara lidhur me përhapjen e Covid-19 në sistemin e burgjeve

Nga informacioni i vënë në dispozicion në rrugë zyrtare rezulton se deri në muajin Qershor 2020, në sistemin e burgjeve **janë identifikuar 21 raste të të burgosurve me COVID-19, përkatësisht 19 raste në IEVP “Jordan Misja” dhe 2 raste në “Mine Peza”**. Sipas DPB-së këta shtetas janë shëruar, përveç një të burgosuri i cili vijon të mbahet në kushte të mira karantinimi dhe ka gjendje shëndetësore të mirë. **Deri më dt. 28 Prill 2020, vetëm 2 punonjës të sistemit të burgjeve rezultuan pozitiv.**

Personat e infektuar me Covid-19 rezulton të jenë karantinuar në **Spitalin e Burgjeve**, ku janë krijuar ambientet e nevojshme.

Pas ndërhyrjes së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Instituti i Shëndetit Publik na vuri në dijeni se deri më Korrik 2020, 202 persona që vuajnë dënimin dhe personel janë testuar. 21 personat e sipër përmendur **janë ndjekur dhe monitoruar nga Shërbimi i Epidemiologjisë dhe Shëndetit Mjedisor pranë Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Tiranë në bashkëpunim me mjekun e burgut përkatës.**

Gjatë periudhës kur vendi ynë u godit nga Covid-19, sistemi i burgjeve reflektoi një institucion të mbyllur. Pavarësisht syrit investigativ të mediave, ishin të rralla daljet televizive të përfaqësuesve të këtij institucioni. Në kuadër të monitorimit, në muajin Mars 2020, KShH kërkoi informacion mbi përhapjen e Covid-19 në sistemin e burgjeve. Në mungesë të marrjes së informacionit nga DPB, KShH ju drejtua nëpërmjet një tjetër shkrese zyrtare DPB-së në muajin Prill 2020. Për shkak të tejkalimit të afateve ligjore, KShH vuri në lëvizje Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në sajë të kompetencave të ushtruara nga ky institucion, na u vu në dispozicion informacion i pjesshëm nga ana e DPB-së. Duke mos hequr dorë nga e drejta e ankimit, pas kontakteve me DPB-në patëm mundësinë të informoheshim rreth situatës dhe gjendjes së të dënuarve ([Njoftim](#))



RASTE SUKSESI TË ASISTUAR LIGJËRISHT NGA KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Shtetasi V.G. është asistuar ligjërisht prej vitit 2017 nga ana e stafit ligjor të KShH-së. Pas konstatimit të dhunës fizike, KShH adresoi në mënyrë institucionale gjetjet dhe rekomandimet përkatëse për zbardhjen e ngjarjes dhe vënien para drejtësisë të autorëve.

KShH përfaqësoi ligjërisht të dënuarin, në cilësinë e viktimës së veprës penale. Gjykata e Rrethit Gjyqësor vendosi pranimin e kërkesës së depozituar nga ana e të pandehurve, për gjykim të shkurtuar dhe dënoi 3 nga të pandehurit për veprën penale "Kryerja e veprimeve arbitrare" dhe 1 të pandehur për "Mosmarrja e masave për ndërprerjen e gjendjes së paligjshme".

Pas depozitimit të ankimit, Gjykata e Apelit vendosi deklarin e pafajshëm të 3 të pandehurve. KShH ka asistuar të dënuarin në përgatitjen e rekursit, ndërkohë që e përfaqëson ligjërisht në procesin civil me objekt kërkimin e dëmit jopasuror. Beteja ligjore vazhdon ...

I dënuari A.N., kërkonte të vuante dënimin pranë familjes së tij, e cila për shkak të largësisë dhe pamundësisë ekonomike e kishte të pamundur realizimin e vizitave periodike. Pretendonte se kishte dërguar disa kërkesa për transferim, por nuk kishte marrë përgjigje. Pas adresimit të ankesës nga KShH, u bë i mundur transferimi i të dënuarit, duke shënuar një hap kyç në riintegrimin e tij në shoqëri



I dënuari L.C., rezultonte se kishte aplikuar për leje të veçantë qëndrimi të përkohshëm në shtëpi, por në mënyrë të pambështetur në ligj kjo leje i ishte refuzuar nga ana e Komisionit të ngritur në IEVP. Ai kishte ushtruar të drejtën e ankimit por Komisioni pranë Ministrisë së Drejtësisë kishte refuzuar dhënien e kësaj leje. Duke sjellë në vëmendjen e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë të drejtën për të aksesuar në Gjykatë dhe vështirësitë e garantimit të mbrojtjes falas, stafi ligjor i KShH-së asistoi të dënuarin për depozitimin e kërkesës për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit.



ROLI ADVOKUES I KSHH NË ADRESIMIN E REKOMANDIMEVE DHE SUGJERIMEVE PËRKATËSE

“

Komiteti

Shqiptar i Helsinkit është përfshirë në mënyrë aktive në procesin konsultues të paketës ligjore të sistemit të burgjeve. Pjesa më e madhe e rekomandimeve dhe sugjerimeve të KShH, të cilat janë identifikuar nga rastet praktike të trajtuara, janë përfshirë nga ana e Komisionit Parlamentar të Ligjeve në Ligjin "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve} (Njoftim).

E drejta për punësim e të burgosurve përbën një element, për të cilën 2 të dënuar të akomoduar në IEVP Fier, pretendonin se nuk ju njihej për shkak se janë dënuar me mbi 15 vite burgim ose nuk kanë pranuar fajësinë lidhur me veprën penale që ka kryer. Pas studimit të akteve ndërkombëtare dhe frymës që synon ligjëvënësi shqiptar të përcjellë mes parimeve. KShH i rekomandoi DPB-së marrjen e masave konkrete për shmangien e kriterëve ekstra ligjore, me qëllim rehabilitimin dhe riintegrimin e të dënuarve.



***Si u reflektua
rekomandimi
i KSHH ...***

Nga korrespondenca zyrtare e përcjellë nga DPB lidhur me këto 2 raste, KShH vlerëson se pranimi i veprës penale nuk duhet të përbëjë shkak për të cilësuar një të dënuar si person jo të rehabilituar. Gjithashtu, trajtimi preferencial i të dënuarve mbetet një shqetësim për çdo aktor të shoqërisë civile apo institucional, por nuk duhet të shndërrohet në kufizim të pambështetur në ligj, të së drejtës për punësim, vetëm duke u mbështetur në faktin se i dënuari/paraburgosuri është kreu apo pjesëmarrës në organizata kriminale apo dënuar për krime të rënda e të gjata në kohë. Një qasje e tillë vlerësojmë se përbën diskriminim bazuar në rrezikshmërinë shoqërore të individit dhe veprës penale, duke mos garantuar riintegrimin e këtyre individëve në shoqëri dhe duke nxitur recidivizmin.

Përfaqësim ligjor falas i shtetasve të dënuar dhe të paraburgosur

Në zbatim të kësaj nisme, avokatët e KShH-së do të përfaqësojnë ligjërisht FALAS shtetasit e dënuar/paraburgosur, të cilët janë pjesë e grupeve vulnerabël dhe nuk kanë mundësi financiare për të ndjekur gjyqësisht çështjen në ngarkim të tyre.

Stafi ligjor i KShH-së ka ndërmarrë takime periodike me stafet e sektorëve ligjorë të IEVP 313, 302 dhe 325, me qëllim identifikimin e rasteve potenciale, për ndërmarrjen e rrugëve ligjore për reduktimin e popullatës në sistemin e burgjeve.

Nga këto takime, stafi ligjor ka identifikuar 3 raste, të cilat paraqiten potencialisht të suksesshme. Pas studimit të dosjeve nga ana e KShH-së dhe marrjes së informacionit nga sektori psiko-social dhe shëndetësor do të vijohet me depozitimin në Gjykatë të kërkesave për ndryshimin apo zëvendësimin e masave të sigurisë, si dhe ndjekjen e rrugëve të tjera ligjore, në funksion të garantimit të të drejtave të këtyre shtetasve dhe nxitjen e rehabilitimit të tyre në shoqëri.



Ky buletin informues realizohet në kuadër të projektit "Të drejtat e personave të privuar nga liria në gjendjen e fatkeqësisë natyrore", të mbështetur financiarisht nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.